

Partizani/ Tifozet "kaben" me policine jashte stadiumit

nga AlbaniaSoccer
E diel, 15 Dhjetor 2013 20:55



Tifozet e Partizanit kane qene te pranishem jashte stadiumit Qemal Stafa kur po luhej ndeshja me Besen. Te denuar per te munguar ne kete takim, rreth 20 tifoz te kuq kane perkrahur skuadren e tyre jashte Qemal Stafes. Policia i ka larguar fillimisht dhe ata me pas kane gjetur nje tjeter vend jashte dyerve te stadimit. Thirrjet "Forca Partizon" ushtonin nga jashte. Policet i larguan disa here por tifozet e kuq nuk hiqnin dore nga deshira per te perkrahur Partizanin qe ja shperbleu ne fushe duke fituar me rezultatin 3-1.